



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. _____ Prot.

Patos, më ____ / ____ /2024

DETYRË PROJektIMI

Objekti: "Ndërtim muri mbajës me struktura metalike për përforcim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitjet e dherave"

Vendndodhja: Rruga "Demokracia", Lagjja "1 Maj", Patos

Investitori: Bashkia Patos

Gjendja e Objektivit

Objekti që kërkojmë të investojmë ndodhet në "Lagjen 1 Maj", në pjesën veri- perëndimore të qytetit të Patosit. Gjatësia totale e murit është 65 m. Sipërfaqja e rrugës që do të rikonstruktohet është 350 m².

Gjendja aktuale është në kushte jo të mira e cila rrezikon dhe cënon rrugën si dhe objektet 5 katëshe që ndodhen aty.

Si rrjedhojë e vështirësisë së ndërhyrjes përgjatë viteve në këtë zonë, koston së lartë që ka realizimi i këtij projekti dhe terrenit kodrinor të zonës që karakterizohet nga bazament me aftësi mbajtëse të ulët, qëllimi i ndërhyrjes është mbajtja nën kontroll dhe parandalimi i fenomenit të rrëshqitjes së dherave.

Në këto kushte ky segment është problematik për banorët dhe automjetet që qarkullojnë dhe konsiderohet e domosdoshme ndërhyrja në rikonstruksionin, sistemimin dhe përmisimin e qarkullimit në zonë.

Zona në të cilën do të ndërhyhet është mjaft e vështirë e cila ka në afërsi të saj dhe objekte banimi dhe fenomeni i rrëshqitjes kërkon një menaxhim shumë të saktë për të shmangur pasojat të cilat mund të vijnë nga avancimi i shkarjes. Në këto kushte është bërë një përzgjedhje e tillë me qëllim sistemimin e zonës duke respektuar të gjitha kriteret teknike dhe standartet në fuqi.

Qëllimi i Projektit:

- Parandalimi i avancimit të procesit të rrëshqitjes së dherave në zonë.
- Krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme dhe të sigurtë për banorët e zonës

Objektivat e realizimit të këtij projekti janë

- Ndërtim mur mbajtës me strukturë metalike (tip palankola) për frenimin e fenomenit të shkarjes dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së rrugës.
- Lëvizjen e sigurtë të kembësorëve dhe automjeteve.
- Sistemimin e infrastrukturës së zonës.

Detyrat që duhet të zgjidhë projekti:

1. Gërmim dhe skarifikim të shtresës sipërfaqësore ekzistuese të rrugës
2. Realizim dhe montim i palankolave metalike.
3. Ndërtim të trupit të ri të rrugës me paktën e rë të shtresave asfaltike
4. Preventivi të bëhet me çmimet manuale në fuqi dhe duke u shoqeruar me analizat per zërat e punimeve që nuk janë parashikuar në manualet e miratuara.

Konceptoi: Gazmira Plesati



Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Ermenita Mici

